



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2024:099480
Datë: 28.01.2025
Numri i dokumentit: 06769894

P.nr.289/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM- Gjyqtarja e vetme gjykuese Blerta Kelmendi, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Leonita Lajçi Muçaj, në çështjen penale ndaj të pandehurit B.Z, nga fshati, komuna e Rahovecit, për shkak të veprës penale “Ngacmimi”, nga neni 182 paragrafi 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.320/2024 të datës 25.03.2024, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar publik të datës 08.01.2025, të mbajtur në prezencën e Prokurorit të Shtetit Ermal Demhasaj, i pandehurit B.Z, me datën 10.01.2025, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 28.01.2025, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

B.Z, i lindur me datë në fshatin, Komuna Rahovecit ku edhe tani jeton, nga i ati Q., dhe e ëma Gj., e gjinisë, i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion bujk, i gjendjes së dobët ekonomike, posedon nr.tel,me numër personal ID-, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, **mbrohet në liri**.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Me datën 14.12.2023 rreth orës 09:50 minuta në lagjen në Pejë, i pandehuri përfshihet në sjellje të vëmendjes së vazhdueshme dhe të pa dëshirueshme me qellim të ngacmimit, frikësimit personin tjetër këtu të dëmtuarën L.D shtetase e Republikës së Shqipërisë tani me banim në Komunën e Pejës, cila kishte qenë ë lidhje intime me të pandehurin, dhe gjatë kësaj kohe duke komunikuar me mesazhe në platformat Messenger dhe Snapchat me të pandehurin kishte dërguar foto me pjesë intime të trupit i revoltuar pasi e dëmtuara kishte shkëputur lidhjen intime kohë më parë, i pandehuri kishte vazhduar duke përndjekur, duke dërguar SMS në vazhdimësi me përmbajtje fyese, kërcënues si “Okej do të shofim, të gjitha bisedat dhe fotot do ti publikoj

*në rrjetin social Facebook dhe dua ta kërkoj burrin tënd kur të jap deklaratën në polici etj,”
ashtu që tek e dëmtuara ka shkaktuar shqetësim të madhe emocional dhe frikë*

- Me çka ka kryer veprën penale “**Ngacmimi**” nga neni 182 parag.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata, ne bazë të nenit 7, 8 par. 1, 9, 10, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69, 70, nenit 182 par. 1 i KPRK-së, nenit 364, 449, 452, 460 të KPRK-së, të akuzuarin e:

G J Y K O N

- I.** Me **DËNIM ME GJOBË**, në shumë prej një mijë (1000) euro, të cilin dënim i pandehuri obligohet të e paguaj brenda afatit prej tre (3) muajsh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit.
- II.** Nëse i pandehuri refuzon, dështon apo nuk paguan dënimin e shqiptuar me gjobë në afatin e caktuar, i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgimi duke i llogaritur shumë prej njëzetë (20) euro për një ditë burgimi. Nëse i njëjti nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën në tërësi, gjykata do ta zëvendësojë pjesën e mbetur të gjobës me burgim. Nëse i njëjti e paguan pjesën e mbetur të gjobës, ekzekutimi i dënimit me burgim ndërpritet.
- III.** I pandehuri obligohet që gjykatës të paguan shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor në shumë prej tridhjetë (30) euro, dhe shumë prej njëzetë (20) euro në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit
- IV.** E dëmtuara L.D me vendbanim në Lagjen, Komuna e Pejës, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm, me datë 25.03.2024 ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.320/2024, ndaj të pandehurit B.Z nga fshati, i Komunës së Rahovecit, për shkak të veprës penale “Ngacmimi” nga neni 182 paragrafi 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur seancën fillestare me datë 08.01.2024, në të cilën kanë prezantuar Prokurori i Shtetit Ermal Demhasaj si dhe i pandehuri B.Z.

Pas leximit të aktakuzës PP/II.nr.320/2024 të datës 25.03.2024, nga ana e Prokurorit të Shtetit, në seancën e shqyrtimit fillestar, gjykata është bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën dhe

tutje ka udhëzuar të pandehurin për kushtet, benefitet dhe pasojat e pranimit të fajësisë, dhe pasi që i pandehuri B.Z, ka deklaruar që i ka kuptuar pasojat dhe përparësitë e pranimit të fajësisë të njëjtit i është dhënë mundësia që të deklarohet për pranimin ose mos pranimin e fajësisë me ç'rast i njëjti me vullnet e vetëdije të plotë ka deklaruar se *e pranon fajësinë* për veprën penale e cilat i vihet në barrë, se ndihet i penduar dhe premtos se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra të tjera penale.

Andaj, gjykata ka marrë mendimin e palëve në procedurë lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, me ç'rast Prokurori i Shtetit Ermal Demhasaj, ka deklaruar se: *pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.*

Në vijim, gjykata ka shqyrtuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në raport me dispozitën ligjore të nenit 242 par. 2 nën par. 2.1, 2.2, 2.3 dhe 2.4 të KPPRK-së, dhe gjeti së në rastin konkret të gjitha këto kushte janë përmbushur në mënyrë kumulative.

Kjo për faktin së gjykata ka gjetur së i akuzuari i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, një pranim i tillë paraqet shprehje të lirë të vullnetit të të akuzuarit, e që pranimi i fajësisë nga ana e tij po ashtu gjen mbështetje edhe në provat materiale siç janë: *Raporti fillestar i Incidentit 2023-DA-2100 të dt. 14.12.2023 i Oficerit Policor B. H. KPS 9750, Raporti Policor të dt. 14.12.2023 nga A.L.KPS 9750, Raporti Informues i Policit Hetues E. S. #2788 e dt. 14.12.2023, Deklarata e të dëmtuarës L.D të dhënë në Nën Stacionin Policor në Gorozhdec me datën 14.12.2023, Deklarata e të pandehurit B.Z e dhënë në Stacionin Policor Pejë dt. 14.12.2023, transkriptet të bisedave telefonike përmes rrjetit social Facebook dhe Messenger.* Po ashtu, gjykata ka gjetur së aktakuza në fjalë nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, ashtu që konform dispozitës së nenit 242 par. 6 të KPPRK-së, ka miratuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Pasi që palët njëzëri kanë deklaruar se nuk propozojnë që të caktohet seanca e posaçme për matjen e dënimit e paraparë me nenin 356 par.1 të KPPRK-së, gjykata ka vazhduar seancën me shqiptimin e dënimit duke i ftuar palët që të deklarohen lidhur me rrethanat rënduese dhe lehtësuese.

Prokurori i shtetit Ermal Demhasaj, ka deklaruar se: *i propozoj gjykatës që në kuptim të rrethanave rënduese të marr parasysh ndonjë dënim eventual të mëparshëm ndaj të pandehurit ndërkaq si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë.*

I pandehuri B.Z ka deklaruar se: *jam penduar për veprën penale të cilën e kam kryer, i kërkoj falje për veprimet të cilat i kam kryer, i premtos gjykatës që në të ardhmen me të dëmtuarën nuk do të kem kontakte e as ndonjë mosmarrëveshje me të, prej asaj dite nuk kam pasur kontakte me te.*

Me faktet e ofruara ne shkresat e lëndës, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike

si është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimit, rrjedh se në veprimet e të pandehurit, qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale “*Ngacmimi*” nga neni 182 paragrafi 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se të i pandehuri ka ekzistuar dashja që veprën penale ta kryej në mënyrë të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, pasi që i pandehuri ka qenë i vetëdijshëm për veprën e kryera dhe e ka dëshiruar kryerjen e saj.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale të të pandehurit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës. Sa i përket fajësisë i pandehuri është i vetëdijshëm për veprën e kryer penale dhe gjykata e ka vërtetuar se e ka kryer me dashje.

Gjyqtarja e vetme gjykuese në bazë të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, i vlerësoi rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, ashtu që si rrethana lehtësuese gjeti se i pandehuri ka bërë pranimin e fajësisë për veprën penale që i vihet në barrë, ka shprehur keqardhje dhe është penduar për veprën penale të cilën e ka kryer, faktin se i njëjti nuk ka qenë i dënuar më parë, ndërkaq rrethana rënduese gjykata mori për bazë edhe faktin se i njëjti është dënuar me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore të Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm, 2021:260752 të datës 24.06.2022, i plotfuqishëm me datën 04.08.2022, për veprën penale “*Ngacmimi*” nga neni 182 par.1 të KPRK-së, përmes të cilit i pandehuri është dënuar me dënim me gjobë në shumën prej 250 € e që dëshmon faktin se i njëjti është recidivist i veprave të natyrës së njëjtë penale.

Andaj, gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të pandehurin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se ky dënim është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë së tij penale dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë dhe është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit e që është pengimi i të pandehurit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale, konform nenit 38 të KPRK-së.

Andaj, gjykata të pandehurit i shqiptoi dënimin me gjobë si në piken I të dispozitivit të këtij Aktgjykimi, e në përputhje me dispozitat ligjore e nenit 42 dhe 43 e lidhur me nenin 182 par.1 të KPRK-së.

Vendimi për zëvendësimin eventual të dënimit të shqiptuar me gjobë me dënim burgimi në rast se i pandehuri dështon apo refuzon ta paguan dënimin me gjobë u morr konform nenit 43 par.3 dhe 4 të KPRK-së.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor, u morr në bazë të nenit 449 par.1 dhe 2, nënpar.2.1 dhe nën par. 2.6, të KPRK-së, ndërsa konform nenit 36 par.1, 2, 3, nën par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, gjykata të pandehurin e obligoi në pagesën e taksës për kompensimin e viktimave të krimit, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Të dëmtuarën L.D, me vendbanim në Lagjen, në Komunën e Pejës, për realizimin e kërkesës pasurore juridike e ka udhëzuar në kontest civil, konform nenit 462 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në kuptim të nenit 364 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE NË PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PENAL
P.nr.289/24, me datë 28.01.2025.

Bashkëpunëtore profesionale

Gjyqtarja e vetme gjykuese

Leonita Lajçi Muçaj

Blerta KERMENDI

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.